

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Emri	Dup	Nr Prot	Sr Prot
	DPK/DMP		03-4271/12
Nr i titullit		Data	
Emri i titullit		Datum	
Nr i pagës	02	Date	26.11.2012
PRISHTINE			

GJL. Nr.1218/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. Juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencioni kundër Korrupsionit-Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Klinë, Regj.I.nr.4096/2012 të dt. 05.10.2012, në bazë të nenit 31, al.3,39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 07.11.2012, mori

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**

ABROGOHET aktvendimi i goditur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Klinë, me aktvendimin Regj.I.nr.4096/2012 të dt. 05.10.2012, ka shpallë përgjegjës të pandehurin Sefë Morina nga fsh.Gllarevë Komuna e Klinës, sepse nuk ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë në afatin ligjor si zyrtar publik gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, këshilltar komunal edhe pse ka qenë e obliguar që ta bëjë për vitin 2012 prej dt.01 deri më 31 mars, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 6.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtar e në bazë të nenit 17.1.1 të të njëjtit Ligj dhe neni 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet, të pandehurit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 150 Euro. Me të njëjtin aktvendim e pandehura është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljeve të Ligjit mbi kundërvajtjet dhe vendimit mbi dënimin, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Thekson se gjykata ka shqiptuar dënimin në kundërshtim me nenin 17 par.1.3 (njëmijepesëqind-dymijepesëqind Euro), të Ligjit nr.04/L-050 ndaj të pandehurit, edhe pse Agjencia Kundër Korrupsionit në kërkesën e parashtruar kësaj gjykate ka bërë kualifikimin juridik, kurse gjykata është thirrur në nenin 17 par.1.1 dhe dënimin e ka zbutë në një masë të madhe në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet, andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe të njëjtës ti shqiptohet dënim meritore në pajtim me Ligjin nr.04/L-050.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarin e dhënë të pandehurit në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 24.09.2012, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

Duke vendosur për ankesën dhe vlerësuar aktvendimin e goditur, si dhe shkresat e tjera të lëndës, Kolegji i kësaj gjykate ka konstatuar se në rastin konkret është bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse se gjykata ka nxjerrë aktvendim në bazë të pranimit në kundërshtim me Ligjin për kundërvajtjet, në bazë të cilit mund të bihet ai aktvendim.

Sipas Ligjit gjykata nxjerrë aktvendim në bazë të pranimit në situatat kur i pandehuri deri në përfundim të seancës kryesore e pranon kundërvajtjen. Gjykata atëherë pa shqyrtim të mëtejshëm nxjerrë aktvendim me të cilin e ka pranuar kundërvajtjen.

Sipas shënimeve të procesverbalit të seancës së dt.24.09.2012, rrjedhë se i pandehuri nuk e ka pranuar kundërvajtjen duke theksuar "se formularët për deklarimin e pasurisë na i kanë dhënë me vonesë dhe kur e kamë marrë formularin ditët e ardhshme ishin vikend, kështu që u vonova për dy ditë dhe kamë vërtetimin për këtë deklaram", por nuk e ka kontestuar vonesën për deklarimin e pasurisë. Me interpretimin e dispozitave ligjore e cila përcakton se gjykata mund të nxjerrë aktvendim në bazë të pranimit vetëm nëse i pandehuri e ka pranuar kundërvajtjen do të thotë se deklarimi i tillë duhet të jetë definitiv e jo që ajo të nxirret nga deklarata e mos kontestimit të vonesës për deklarim të pasurisë. Vetëm mos kontestimi i vonesës nuk do të thotë pranim dhe me këtë shprehje e dëshirës që i pranon pasojat e kundërvajtjes.

Meqë është bërë kjo shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse si dhe në këtë çështje kundërvajtëse gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe drejtë, se gjykata e shkallës së parë është bazuar vetëm në këtë deklaratë të dhënë të pandehurit, ndërsa provat e tjera nuk janë administruar dhe në shkresa të lëndës nuk ka prova për aplikimin e nenit 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet me rastin e zbutjes së dënimit të pandehurit, është nevojë të abrogohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Në plotësim të procedurës gjykata e shkallës së parë duhet të veprimi sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të theksuara më lartë, të merë në pyetje përfaqësuesin e ushtruesit të kërkesës i cili duhet të dëshmoi se kur ka kërkuar nga i pandehuri të bëjë deklarimin e pasurisë si në vështrim të nenit 6 par.1.3, neni 9 dhe nenit 17 par.1.3 të Ligjit nr.04/L-050 dhe me cilën bazë për deklarim të pasurisë, sepse në bazë të neneve që janë vendosur në kërkesën e tyre këto parashohin përgjegjësinë për mos deklarimin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë dhe jo për deklarim të rregullt vjetor siç është vendosur nga gjykata e shkallës së parë, e sipas nevojës të administrohen edhe prova të tjera, e pastaj pas vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të ri duke pas për bazë edhe thëniet e paraqitura në ankesën e organit kompetent Agjencionit Antikorrupsion në Prishtinë, e pastaj të vendos lidhur me këtë çështje kundërvajtëse.


Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJL. Nr. 1218/2012 të dt. 07.11.2012.

SEKJURIDIKE
Sanije Salihu



KRYETARI I KOLEGJIT,
Ramiz Kuqi